



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr. 423, datë 09.10.2020**

**PËR**  
**NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË LARTË**  
**GJYQËSOR NR.405, DATË 07.10.2020**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 94, 95, 113 e 117 të Kodit të Procedurës Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, si dhe në informacionin e dërguar nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me email e datës 08.10.2020, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Ndryshimin e pikës 1, nëndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, paragrafi I, të Vendimit Nr.405, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Kostika Çobanaqi, caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, çështjen penale me të pandehur: Arben Arapi; Akuza: “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**